



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE I KOMUNIKIMIT



**Programi: Bachelor**

**Drejtimi: Gazetari**

**Lënda: Kulturë gjuhësore**

*Pedagogu:* Prof. Asoc. Dr. Linda Mëniku  
*Ngarkesa:* 2 ETCS (15 javë: 1.5 leksione në javë)  
*Lloji i lëndës:* me detyrim  
*Viti/semestri:* I/I

**Përshkrimi:**

Lënda “Kulturë gjuhe” synon t’i pajisë studentët me njohuritë bazë për drejtshkrimin, etnografinë e të folurit dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe. Kjo lëndë synon që studentët të përvetësojnë normat e gjuhës standarde në një nivel të lartë, si një përpjekje për të plotësuar apo për të përforcuar një njohuri të domosdoshme për çdo folës amtar të gjuhës shqipe, e në mënyrë të veçantë për studentë të gazetarisë. Në mënyrë të veçantë, studentët në këtë lëndë do të aftësohen në zbatimin praktik të njohurive të fituara dhe në një qasje më të vëmendshme ndaj normativës gjuhësore në median shqiptare. Lënda “Kulturë gjuhësore” synon të aftësojë studentët për të përdorur në mënyrë sa më korrekte gjuhën standarde shqipe në nivele institucionale dhe në të gjitha sferat e përdorimit të saj. Lënda “Kulturë gjuhësore” është ndërtuar mbi bazën e leksioneve ku temat konkrete trajtohen përmes dhënies së shembujve të shumtë. Leksionet janë konceptuar si leksione ndërvepruese ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive, duke sjellë shembuj të ndryshëm të marrë nga media shqiptare. Studentëve do t’u kërkohet çdo javë mbledhja paraprake e materialit nga media, në lidhje me temën përkatëse javore. Duke u nisur nga materialet e mbledhura, të bazuara kryesisht në gjetjen e shmangieve nga norma drejtshkrimore, në leksion do të sqarohen rregullat përkatëse, duke synuar në të kuptuarit logjik dhe jo thjesht mekanik të normativës drejtshkrimore të shqipes.

**2. Temat e leksioneve**

Java	Tema	Literatura
1	Kongresi i Drejtshkrimit (1972). Parimet dhe rregullat e drejtshkrimit.	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> (1973, fq:1-29)
2	Probleme në përdorimin e shkronjave e dhe ë në pozicione të ndryshme në fjalë. (Pjesa I)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq.39-51

3	Probleme në përdorimin e shkronjave <i>e</i> dhe <i>ë</i> në pozicione të ndryshme në fjalë. (Pjesa I)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq.51-60
4	Probleme në përdorimin e shkronjave <i>i, u, y</i> , si dhe të grupeve <i>ie, ye, ue, ua</i> .	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> fq. 60-65
5	Përdorimi i gabuar i apostrofit.	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 65-70
6	Probleme në shkrimin e shkronjave: <i>Sh, Zh, Ç, S, Z, J</i> .	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 71-79
7	Probleme në shkrimin e shkronjave <i>H, RR, NJ</i> në trup të fjalës.	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 80-85
8	Çështje të shkrimit të grupeve: <i>mb, nd, ng, ngj</i> dhe të takimit të shkronjave: <i>t</i> me <i>sh, g, n</i> me <i>j</i> -në, etj.	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 85-90
9	Emrat e huaj të vendeve dhe të njerëzve-çështje të shkrimit të tyre. (Pjesa I)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 90-97
10	Emrat e huaj të vendeve dhe të njerëzve-çështje të shkrimit të tyre. (Pjesa II)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 97-105
11	Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. (Pjesa I)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq.122-132
12	Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. (Pjesa II)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 133-141
13	Përdorimi i shkronjave të mëdha.(Pjesa I)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 141-150
14	Përdorimi i shkronjave të mëdha.(Pjesa I)	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 150-160
15	Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit dhe shkrimi i datave	<i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , fq. 161-167

### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve
- Angazhimi në seminare: 10% e notës
- *Detyra e kursit*: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5. 10% e notës
- *Kontrolli përfundimtar*: provim me shkrim 80% e notës
- Gjithsej: 100%

**Literatura e detyrueshme për studentin:**

Akademia e Shkencave. “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Tiranë, 1973

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. “Fjalori i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006.